

PASHKO GECI

### FRANG BARDHI DHE FJALORI I TIJ LATIN-SHQIP<sup>1</sup>

Linguisti francez, Mario Roques, i bani një shërbim të madh gjuhës shqipe kur ribotoi në vjetin 1932 — gati 300 vjetë pas botimit të parë — Fjalorin latin-shqip të Frang Bardhit. Sipas parathanes, Mario Roques kishte në mend të bante një edicion të ri të teksteve të vjetra shqipe, por përfaqësuesi i atëhershëm i Shqipnisë në Paris në vend që ta inkurajonte, e pengoi, ose ma mirë me thanë e preu punën e tij. Kështu tekstet e vjetra të gjuhës shqipe nuk u botuen fare, as vëllimi i dytë me treguesin alfabetik komplet të gjitha fjalëve shqipe të fjalorit, që M. Roques e kishte gati për botim, nuk dëgjoi në dritë. Fjalori i Bardhit u shfrytëzue prej leksikografëve të mavonshëm pa ia përmendë emnin dhe u desht një kohë e gjatë deri sa u vu në dukje puna e tij si historian, si shkrimtar dhe leksikograf. Albanologu francez i bani një hymje të çmueshme fjalorit; aty jep informata të sigurta rreth biografisë së autorit dhe mendimin e vet mbi fjalorin. Gati të gjitha vrejttjet e tij tregojnë qartë se ka qenë një njohës i mirë i gjuhës shqipe. Megjithëse i ven në dukje të gjitha të metat e fjalorit, prapëseprap vjen në përfundim se fjalori nuk asht një vepër pa randësi dhe se nuk e ka pasë krejt gabim Matë Dudesi, bashkënxanësi i tij, që e ka naltue me lavde të mëdha.

Randësi të madhe i jep Fjalorit të Bardhit edhe linguisti rumun, Dëmètre Macrea. Ky, në artikullin e botuem me titull «Fjalori shqip i 1635», mbasi flet për punën e madhe që ka ba Mario Roques në hymjen e botimit të dytë të Fjalorit të Bardhit, pjesën ma të madhe të artikullit ia kushton alfabetit shqip të fjalorit. Vrejttjet e tij rreth këtij alfabeti dëshmojnë se ai asht një studiues i mirë i gjuhës shqipe. Në lidhje me fjalorin e Bardhit D. Macrea asht i një mendimi me Xyländer-in dhe Fallmerayer-in dhe përsërit gjykimin e tyne se Fjalori i Bardhit asht tepër i vorfën që t'i përgjigjet qëllimit për të cilin asht shkruar; megjithatë — thotë ai — asht një mjet i shkëlqyeshëm pune për filologët dhe historianët dhe u ka shërbye si gurrë dijetarëve për studime mbi gjuhën shqipe: Franz Bopp-it për veprën «Mbi shqipen në marrëdhënien e saj farefisnore»; Franz Miklosich-it për «Studime shqiptare»; Gustav Meyer-it për «Studime shqiptare» dhe për «Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe».

Në dekadën e fundit pas çlirimit me veprimtarinë e Frang Bardhit filluen të merren studiuesit shqiptarë. Tue u bazue në relacione, që

1) Dictionarium Latino-Epiroticum una cum nonnullis usitatioribus loquendi formulis. Per R.D. Franciscum Blancum epirotam Coll. de Propaganda Fide Alumnum. Fjalor latin-shqip bashkë me disa mënyra shprehje që përdoren ma shpesh. Hartue prej Frang Bardhit, nxanësit shqiptar të kolegjit «De Propaganda Fide».

Frang Bardhi u dërgoi në Romë eprorëve të vet, Injac Zamputi shkroi artikullin: «*Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike, shoqërore e politike të vendit tonë*», botue në «Buletin për Shkencat Shoqërore» nr. 2, 1965. Këtu dalin në dritë të vërtetë ngjarje historike, që historianët e huej i kanë përshkrue shtrembët.

Me rastin e 350-vjetorit të lindjes së Frang Bardhit, Kolë Kamsi botoi në «Buletin për Shkencat Shoqërore» nr. 4, 1956, artikullin «*Frangu i Bardhë*» (1606-1643). Pjesa më e madhe e këtij artikulli i kushtohet fjalorit. Me një kujdes të madh ai shtron të gjitha trajtat e fjalëve të fjalorit dhe flet mbi ndryshimet morfologjike në krahasim me auctorët e maparshëm, me shkrimtarët arbëreshë dhe me gjuhën e socme shqipe.

Disa vjetë më vonë Kolë Ashta, mbasi i bani një studim të imtë fjalorit të Bardhit, botoi në Almanakun «Shkodra» artikullin «*Vëzhgim historik në fjalorin e parë të shqipes. Bardhi 1635*», ku flet gjanë e gjatë mbi përgatitjen kulturore të Frang Bardhit, mbi huazimet, parashtesat dhe prapashtesat e fjalëve në fjalorin e tij.

Orvatjet e Frang Bardhit që me anë të letrave t'ua mbushte mendjen eprorëve dhe miqve në Romë të pranoheshin sa ma shumë nxanës shqiptarë në kolegjin «De Propaganda Fide» për me eliminue sa ma parë misionarët e huej, të cilët nganjëherë i sillshin ma tepër dam se dobi vendit, përpjekjet dhe hapat që bani për ta lirue Shqipërinë prej sundimit të urryem turk, fjalori që hartoi për ta rrujtë të pastër gjuhën shqipe janë provë të qarta dashtnie për vendin, gjuhën dhe popullin shqiptar. Për këtë ai vuni jetën në rrezik dhe vdiq para kohe.

Këtu do të kufizohemi të flasim vetëm për fjalorin latin-shqip, tue prekë sidomos dy anët ma kryesore të fjalorit dygjuhësh: ku asht bazue auktori për mbledhjen e glosarit të fjalorit dhe deri ku u përgjigjen ekuivalentet shqipe lemave latine.

Fjalori i Frang Bardhit latin-shqip, e vetmja vepër shqipe që na ka mbetë prej tij, nuk asht një fjalor i latinishtes klasike, pse qëllimi i tij nuk ishte me ba një fjalor për leximin e veprave klasike. Si bazë për fjalorin e Bardhit u muer gjuha kishtare latine. Në latinishten vulgare u shkruen të gjitha veprat fetare që synojshin përhapjen e fesë, prandaj ishte e domosdoshme për të gjithë njerzit që i shërbejshin kishës të dijshin latinisht. Edhe mbas ramjes së perandorisë së Romës gjuha latine vazhdoi të flitej dhe të shkruhej për një kohë të gjatë prej botës së qytetnueme, përmatëpër me kohë u ba gjuhë shkence dhe deri diku ndërkombëtare, pse shkencëtarët e të gjitha kombeve, për t'u kuptue prej të gjithëve, shkruenë në gjuhën latine. Vetëm me gjuhët klasike mund të fitohej një kulturë e lartë. Auktori i fjalorit mësimet e larta filozofike dhe teologjike pa dyshim i ka ba në gjuhën latine, me tekste latine dhe nuk asht çudi që mbrenda mureve të kolegjit të ketë folë latinisht me kolegët e vet, prandaj nuk ndeshi në vështirësi të mëdha kur mbrenda një kohe të shkurtë përpiloi në një gjuhë të mirë latine apologjinë e Skënderbeut. Patjetër për të ka qenë ma lehtë në atë kohë të shkruente latinisht se sa shqip. Për hartimin e fjalorit auktori zgjodhi rrugën ma të vështirë dhe ma shkencore, por

edhe ma të sigurtë: lexoi një sasi veprash fetare dhe regjistroi fjalët që do të hyjshin në fjalor tue i marrë nganjëherë bashkë me kontekst; prej këtej e pat ma lehtë të nxjerri kuptimin në shqipen. Kështu formoi një lloj kartoteke për leksikun e fjalorit, që nuk mjaftoi për një fjalor të plotë latin-shqip, pse numri i veprave të lexueme qe shumë i kufizuem ose ma mirë me thanë pse regjistrimi i fjalëve nuk u ba si duhet. Me atë material që grumbulloi auktori fjalori duel i vorfën; po të heqim fjalët që përsëriten në trajta të ndryshme dhe shembujt që figurojnë më vete, fjalori nuk do të kalonte numrin e 4500 fjalëve. Për një gjuhë të pasun, sikur ishte latinishtja, ky numër ishte tepër i vogël, tue pasë parasysh edhe se fjalët janë vu vetëm në një kuptim, në kuptimin e tekstit. Kështu fjalori pasqyron vetëm një pjesë të leksikut të latinishtes, kjo sasi fjalësh mund të mjaftonte vetëm për fjalë të rralla të latinishtes.

Foljet janë vu zakonisht në mënyrën paskaiore, sikur praktikohet sot ndër gjuhët moderne, por nuk mungojnë edhe trajta të tjera të foljes që figurojnë më vete. Kështu kemi: *amare*, me dashiun: *amari*, me u dashjun; *amans* ai që do; *amatus*, dashiun. *Solemus*, kemi zakon; *solet*, ka zakon: *solitus*, mbsuem; *solitus est male facere*, asht mbsuem me bam keq. Kështu edhe shembujt ilustrues për fjalët «*aqua*» e «*non*» figurojnë më vete: *aqua*, ujë: *aqua salsa*, ujë të shëllijm: *aqua dulcis*, ujë tamblë: *aqua clara*, ujë të kulluem: *aqua turbida*, ujë të turbulluem. *Non*, jo; *non est*, s'ashtë; *non amo te*, s'të due; *non amare*, me mos dashjun; *non esse*, me mos qenë, *non sum ego*, s'iam u. Këto dhe sa fjalë të tjera tue u vu më vete e kanë rritë numrin e fjalëve, por jo të kuptimeve. Në fjalorin latin-shqip auktori nuk asht nërherë konsekuent, herë e ven fjalën bazë, herë s'e ven, nganjëherë fillon me shembuj ose me ndonjë trajtë tjetër të fjalës, pse kështu i ka ardhë ma i lehtë përkthimi. Leksiku i shqipes pasqyrohet edhe ma i vorfën (Kolë Ashta ka numrue vetëm 2544 fjalë). Kjo ka rrjedhë jo vetëm se fjalët sinonime të latinishtes janë përkthye në shqipen me të njatën fjalë dhe në disa rasa fjalori dygjuhësh ban shërbimin e fjalorit shpjegues, por edhe se shumë fjalë të latinishtes me kuptime të ndryshme ose mjaft të largta, për mungesë fjalësh, janë dhanë në shqipen me një fjalë të vetme. Mjafton të thomi se «*lucrum, praemium, victoria*» kanë ekuivalentin «ngallënjim» e *lucrari, praemiari, pervincere, superare* «me nallëngjyem», *Apostata, rebellator, grassator*, fjalë që kanë kuptime krejt të ndryshme, janë dhanë në shqipen me ekuivalentin «hajn» dhe *palpebrae, pupilla, supercilium*, tri fjalë që shprehin nocione të ndryshme, janë përkthye shqip me fjalët «vetullat e vetulla». *Mendicus, orphanus, pauper*, kanë ekuivalentin «i vobeg», që i përgjegj vetëm fjalës së fundit.

Bardhi desht të bante një fjalor praktik që t'u shërbente edhe atyne që nuk kishin njohuni gjuhësore. Ai e dinte mirë gjendjen e ultë kulturore të klerit shqiptar, që lexonte për ditë librin e meshës dhe lutjet e ndryshme, por nuk kuptonte gja; mu për t'u ardhë në ndihmë këtyne hartoi të parin fjalor latin-shqip, dhe për me e ba ma të lehtë e ma të sigurtë përdorimin e tij nuk i ngarkoi fjalët me kuptime të ndryshme, por u mjaftue me kuptimin e tekstit të vjelun. Në këtë mënyrë dhe me anë të shembujve që sjell për ilustrimin e kuptimeve auktori ka

mendue se fjalori i tij do të shërbente si një gjysmë përkthimi në leximin e teksteve fetare. Shembujt si: *confido in nostro Domino*, shpërejnj në Tenëzonë; *Deus prohibeat*, Zotynë e largoftë; *intercede pro nobis*, lutu për ne; *obsecro te precibus*, të lutem me uratë; *per Deum, qui est super Coelos*, per Tenëzonë, që ashtë mbi Qiellt; *rapere mulierem alterius*, me grabitunë gruenë e tjetërit; *repudiavit uxorem*, lëshoi gruenë; *restituere res alienas*, me nkëthyem gjanë e huej, *sub manu Dei nostri*, ndenë doret të Tinëzot; *tam amo illos, quam vos*, aqje due ata, sa due ty; ashtu edhe fjalët latine, që janë dhanë në shqipen me një kuptim krejt të dytë ose të figurshëm si: *acies*, trimnia; *color* fytyrë, të pam; *mordere*, me folë keq; *oratio*, uratë; *praenatare*, me lagun; *profundere*, me folë nkot; *tergus*, lëkurë e sa të tjera, tregojnë qartë se auktori ka marrë parasysh vetëm kuptimin që nxiret prej tekstit. Me këtë leksik të vobektë, ku u lanë jashtë fjalë të zakonshme dhe të përditëshme si: *andacia, brevis, cadere, doctrina, ire, liber, libertas, magnus, missa, munire, terrere, vincere, virtus* e shumë të tjera, që ndoshta auktori i ka nënkuptue të njoftuna prej të gjithëve, dhe u strehuen fjalë shumë të rralla si: *coliphium*, pogaçja; *omphacium* grestë; *oppicare*, me pegulluem; *popinatio*, të shëdejmitë; *praestinare*, me blem; *rumare*, me shtim sisënë ndë gojë; *ruspari*, me kërkuem fort, *sesquimedium*, nja grumbull e gjymsë, e sa të tjera, fjalori nuk dha rezultatin e dishruem. Për këtë duhet të ketë qenë i bindun edhe vetë auktori, pse megjithë kërkesën e klerikëve, fjalori nuk u botue përsëri. Sigurisht auktori kishte në mend ta ribotonte mbas disa vjeç të plotësuem dhe të ndrequn, por vdekja e parakohëshme e këputi punën e tij.

Prapseprap edhe kështu fjalori, në atë kohë, e ka ba shërbimin e vet; përveç klerikëve shqiptarë, fjalorin e kanë përdorë edhe misionarët e huej, që kishin ardhë në Zadrinë një vit para se të kthente Frang Bardhi si ipeshkev. Kot nuk lajmonte Bardhi në Romë me kënaqësi të madhe se fra Kerubini e kishte nxanë aq mirë shqipen, sa tashti predikonte pa përkthyes; këtu patjetër mund të ketë kontribue shumë fjalori i tij.

Një randësi edhe ma të madhe se glosari në një fjalor dygjuhësh ka kuptimi i fjalëve. Këtu qëndron sidomos aftësia e leksikografit: po nuk u gjet ekuivalenti i duhun në gjuhën tjetër, fjalori nuk mund të ketë vlerë të madhe edhe sikur t'i ketë në rregull të gjitha anët e tjera. Natyrisht fjalorin e parë dygjuhësh të Frang Bardhit, që asht botue para 330 vjeç, duhet ta shikojmë me një sy tjetër, pse ky bani hapin e parë në leksikografinë shqipe dhe u hapi rrugën të tjerëve. Auktori ndeshi në vështirësi të pakapërcyeshme, pse në njënë anë kishte gjuhën latine me një zhvillim të plotë dhe letërsi të pasun, në tjetrën vetëm gjuhën shqipe popullore pothuëj të papunueme, që auktori tue u gjetë larg vendit të vet për një kohë të gjatë filloi ta harronte. Këto pengesa qenë aq të mëdha, sa disa herë e detyruen të hiqte dorë përgjithmonë prej hartimit të fjalorit, dhe kjo do të kishte ndodhë me siguri, sikur mos të kishin qenë të tjerët, që e nxitën t'i jepte fund veprës së fillueme.

Deri diku edhe shtypi ka mujtë me qenë shkaktar i disa të metave që vrehen në fjalor, pse këtu ngatërrohen njeni me tjetrin edhe kup-

timer e fjalëve ma të thjeshta. Megjithëse për një kohë të gjatë në dhé të huej dhe pa pasë rasë me kë me folë shqip, asht e pabesueshme që auktori mos të ketë qenë i sigurtë cila dorë në shqipen quhet e *djathtë* e cila e *majtë*, cili shpend grabitqar quhet *shqype* e cili *falkue*. Këtu jepen *vetullat* për *qepalla*, *cjapi* për *dash*, *kofsha* për *brinjë* e *rruzat* e *shpinës* për *veshke* sikur do ti shofim prej shembujsh që ndjekin:

*Ambidexter*, emën që do të thotë «njeri që punon me të dyja duert sikur me të djathtën, që punon edhe me të majtën si me të djathtën, ka të njejtin ekuivalent në shqipen me mbiemnin «sinister» i shtëmangtë. Shprehjet: «a dextra» dhe «a sinistra», që kanë kuptime krejt të ndryshme, në fjalor figurojnë me të njejtin ekuivalent «mbë të djaftët dhe mbë të djathëtët».

*Aquila* dhe *falco* kanë të njajtin ekuivalent «falkue», nësa lema latine «*milvus*» (qifti) ka ekuivalentin «shqypeja», që i përgjigjet plotësisht fjalës latine «*aquila*».

*Aries* (dashi) dhe *caper* (cjapi) kanë ekuivalentin «sjap», por te lema latine «*vervex*», që do të thotë «dash i tredhun» asht vu ekuivalenti «dash», që i përket fjalës në kryerresht «*aries*».

*Costae* (kofsha). Këtu asht vu ekuivalenti i fjalës fonetikiisht të afërme «*coxa*», që nuk figuron në fjalor. *Costae* vetëm në shumë domethanë «ijet» e në njejës «*costa*» ka kuptimin «brinjë».

*Palpebrae*, *pupilla* dhe *supercilium* kanë të njajtin ekuivalent: *vetullat* e *vetulla*. Vetëm fjala e fundit ka këtë kuptim, pse *palpebrae* do të thotë «qepalla» dhe *pupilla* «bebëza» (e synit).

*Renes*, ruezat e shpinës. Këtij ekuivalenti i përgjegj fjala latine «*vertebrae*», që nuk figuron në fjalor, nësa *renes* janë veshket.

Ekuivalentin e duhun nuk e kanë as fjalët: *apostata*, hajn; *infans*, djalëth shtatë vjeç; *rebellator*, hajn; *rebellare*, me u bam hajn; *rebellio*, hajnia; *in decōrus*, horrjat; *orphanus*, i vobeg; *peridoneus* i ditun e sa të tjera, por auktorit i kanë mungue fjalët shqipe. Megjithatë fjalori ka vlerë gjithnjë, pse përmban edhe fjalë të përkthyme mirë, nganjëherë në mënyrë popullore, praptike, por bukur dhe qartë: *absit*, goftë larg; *apage*, shko tokës; *matrescit filius* gjet samës i biri; *nescius*, s'di; *pallaca*, grue mbi grue, *paritura*, në të pjellët; *patres conscripti*, etent e kuvendit; *pervius*, ka mund të shkohet; *poculentus*, munë pihetë; *prosper*, tumirë; *prosperare*, me votë tumirë; *semesus*, gjysma ngranë; *simultas*, miqësi e rreshime, *singuli*, gjithkush për vetehe; *spectamen*, ke shemelltyrë; *uniter*, me nja besë e sa të tjera. Në fjalorin e Bardhit ndeshim një sasi fjalësh, që janë zhdukë për një kohë të gjatë dhe kanë hy përsëri në përdorim si të ishin neologjizma: ndigjues (auditor), këshilltar (consiliator), detorës (debitor), kopështar (hortolanus), gjetës (inventor), kërkues (investigator), me gethëletuem (prolectare), me grishun (invitare), letërar (litterator), kandërej (locusta), shitës (venditor), tregëtar (mercator), luftëtar (bellator, pugnax), shpenzues (opsonator), me dhendunë (prosecare), palaré (platina), shyrëtues (pensitator, quaesitor), me shyrëtuem (pensitare), shyrëtim (quaestio), ruezatë e shpinës (renes), djekësitë (sequaces), andërrues (somniaosus), divënyes (vates) e plotë të tjera; ndoshta ka qenë fjalori i Bardhit që i ka kthye përsëri në jetë këto fjalë. Këtu dalin edhe disa diminutiva, që i takojmë ndër shkrime të soçme si: liberth (libellus), djalth (puer), shtratth (lectulus), shtëpiza (ligellum), barkëza (navicula), mikth (amiculus), reza (nubecula), mikeshëza (ami-

cula), sakicëza (securicula), zogth (avicula) etj. Këto trajta zvoglimi me «th» e «z» pa dyshim Bardhi i ka gjetë në gjuhën e popullit, pse figuronjë edhe ndër shkrime të maparshme, por për hir të ekuivalentit të duhun në shqipen mund të ketë krijue fjalë të tjera pas këtij modeli, sikurse ndodh edhe sot ndër përkthime të veprave të hueja.

Ai që lexon sot Fjalorin e Bardhit mund të vrejë ndryshime që ka ba gjuha tue e krahasue me të soçmen. Shumë mbiemna, që sot janë të nyjshëm, sipas Bardhit, në atë kohë kanë qenë pa nyjë. Në fjalorin e Bardhit gjejmë: *albus*, bardhë; *amarus*, hidhun; *calidus*, nxetë; *densus*, shpesh; *frigidus*, ftofëtë; *lacerus*, rjepun; *limpidus*, kulluem; *longus*, gjatë; *luridus*, zbetë; *obliquus*, shtremenë; *perbrevis*, fort shkurtën; *percrudus*, papjekun *sanus*, shëndosh; *viridis*, verdhë; *vivus*, gjallë. Krahas me këta fjalori ka edhe një shumicë të madhe mbiemnash me nyjë të parme si *durus*, *fortis*, *validus*, i fortë; *dives*, *locuples*, *opulentus*, i begatë; *mansues*, *mitis*, i butë; *niger*, i zi; *pauper*, *orphanus*, *mendicus*, i vobeg; *parcus*, i shtrejtë; *parvus*, i vogël; *speciosus*, i bukur; *sublimis*, i naltë, *subtilis*, i hollë; *surdus*, i shurdhënë; *temperans*, i përkuerm; *vastus*, *vehemens*, i madh; *velox*, *vivax*, i gjallë; *verax*, i vërtetë e sa të tjerë. Këtu mund të gjindet edhe i njajti mbiemën me nyjë dhe pa nyjë të parme si: *aeger* i sëmutë; *agrotus*, sëmutë; *vivax*, i gjallë; *vivus*, gjallë, me këtë ndoshta ka dashtë të japi ndonjë nuancë kuptimi, por ekzistenca e mbiemnave pa nyjë të parme mund të vërtetohet edhe me auktorë të tjerë të letërsisë së vjetër shqipe. Mbiemnat e participat e adjektivuem pa nyjë, që i ndeshim te Bardhi, reflektojnë hymjen e vonshme në shqipen të nyjës së parme. Nyjën e parme e kanë përherë mbiemnat me prapashtesat *-shim* e *-çim*, që kanë mbetë aty-këtu si trajta arkaike dhe në gjuhën e soçme kanë dhanë *-shëm* e *-çëm*: *docilis*, i mbsueshim; *grandaevus*, *priscus*, i moçim; *impudens*, i pambarshim; *insuavis*, i papëlqyeshim; *invictus*, i pangallënyeshim, i papushtueshim; *lepidus*, i pëlqyeshim; *pavens* i frigshim; *praepotens*, shumë i pushtetshim; *sapiens*, i ditëshmi; *spectabilis*, i dukshim, i pashim; *vorax*, i unëshim etj. Ashtu edhe mbiemnat zvogëlues gati pa përjashtim marrin nyjën e parme: *iuvenalis*, i rith; *lepidus* i bukurith; *minusculus*, *modicellus*, *pusillus*, i vogëlith; *mollis*, i njomëth; *nigellus*, i zith etj. Tue u bazue këtu mund të thomi se prapashtesat *-shin* e *-çim* ashtu edhe diminutivat e adjektivave i përkasin një kohe të mavonshme, nësa mbiemnat pa nyjë duhet të jenë ma të vjetër. Përsëri te Bardhi takojmë një sasi të madhe mbiemnash cilësorë që i prijnë emnit, përmatëpër mund të thomi se këtu ma shpesh mbiemni cilësor i prin emnit se sa e ndjek: *alta gallina*, e majme pulë; *bona mulierë* e mirë grue; *bonus dies*, e mirë ditë; *dulce pomum*, e ambël mollë; *formosa mulier*, e bukur grue. Por: *audax vir*, njeri i fortë; *dextera manus*, dora e djathtë; *mammosa mulier*, grueja sisëmadhe:

Shumica janë të mendimit se këto janë imitime të ndërtimit latin. Prof. Eqerem Çabej, që i bani një studim mbiemnit në shqipen në artikullin e botuem në «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore» nr. 3, 1963, me titull «Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe», thotë se gjendja e hershme e gjuhës bashkë me të sotmen tregon që pozicioni i mbiemnit pas emnit paraqet ndërtimin normal, përveç rasave në leteraturë ku ka imitime modelesh së hueja. Këtu natyrisht mund të përfshihej edhe fjalori i Bardhit, por mbas mendimit tonë gjithnjë mbetet mundësia e mbiemnit

prepozitiv sikur ndër përemna pronës dhe të pakufishëm, që adjektivu-  
em. pse te Bardhi i ndeshim të dyja ndërtimet për të njajtin tog  
fjalësh: *altus homo*, i naltë njeri dhe njeri i naltë; shifet se auktori  
lëkundet para këtij ndërtimi; koha e Bardhit, si duket, ka qenë periudhë  
kalimtare si për mbiemnat e nyjshëm (*aeger* — sëmutë; *aegrotus* — i  
sëmutë) ashtu edhe për mbiemnat postpozitivë. Mbiemni prepozitiv  
gjindet te Bardhi jo vetëm në fjalor, por edhe në parathanien e fja-  
lorit, që s'asht përkthim i latinishtes. Në të lexojmë: «... me ndimuem  
gjithë atyne që janë ndurdhenitë tinzot e të *Shintesë* Kishë Katolike,  
e s'dijnë gjuhën latine, pa të sijet as kush s'mundë shërbenjë si duhet e  
pa të *madh error*...» Edhe shprehjet emfatike, urimet, mallkimet e  
pashirrmat, për të cilat bahet përjashtim, kan fillue të lëkunden për-  
sa i përket mbiemnit prepozitiv. Një kangë e vjetër popullore dasme  
shkodrane fillon me fjalët: «Mirë mrama, mirë mrama N. N.» Por sot,  
në bisedën e përditshme shkodrane thuhet zakonisht «mramja (e) mirë»  
dhe «nadja (e) mirë».

Në krahasim me kategoritë e tjera gramatikore ndajfoljet pas-  
qyrohen ma mirë në fjalor; auktori ka tregue ma kujdes për to dhe i  
ka dhanë në shqipen me një larmi të madhe. Shumica e tyne janë mbi-  
emna ose participa të adjektivuem pa nyjë, pastaj vinë mbiemnat me  
prapashtesa të ndryshme dhe mënyra të tjera formimi: mshefun (*clam*),  
fështir (*difficile*), dësherueshim (*cupienter*); pahieshim (*indecenter*), da-  
shim (*interrupte, separate*), sdurueshim (*intoleranter*), zmirueshim (*in-  
vidiose*), ndriçim (*lucide*), mënishim (*odiose*), pëlqyeshim (*urbane*),  
shkëlqyeshim (*opulenter*), mnerueshim (*pavide*), lëshueshim (*petulan-  
ter*), pervushim (*remisse*), ditëshim (*scite*), madhshtueshim (*superbe*),  
miqësisht (*amice*), vëllaznisht (*fraterne*), dhëlpënisht (*fraudenter*),  
mrekullisht (*mirabiliter*), dhunisht (*turpiter, pudenter*), tinëzë (*furtim,  
occulte*), pash mbë pash (*gradatim*), pikë, pikë (*guttatim*), herë, herë  
(*interdum*), copë, copë, (*frustatim*), premenë (*nominatim*), prudhë (*pere-  
gre*) etj. Si duket gjuha e popullit ka dashtë përherë variacion.

Trajtat që sot i kanë të folmet e jugut si: kështenjë (*castenea*),  
zonjë (*hera*), e zonja e shtëpisë (*domina*), gjunjëtë (*genua*); hujnj (*pa-  
lus*), gosti (*convivium*), shinj i keq (*omen*) llukanikatë (*farcimen*) ashtu  
edhe të gjitha foljet në të tashmen me mbaresën «-nj» që i takojmë  
ndër shembuj si: shperenj... (*confido*), dëshëronj fort (*expetisco*),  
thithinj... (*exugo*) mashtrojn (*fallo*), vinjenë (*veniunt*), kërkonj (*gusto*),  
shukojnj (*inspicio*), lidhinj (*necto*), nxijnj (*nigresco*), ruojnj (*reservo*),  
e sa të tjera, që gjinden në fjalor, janë një dishmi e qartë se dy  
dialektet kryesore në atë kohë kanë qenë ma afër se sa sot.

Fjalori i Bardhit ka randësi historike, pse asht i pari monument  
në leksikografinë shqiptare me anët e veta pozitive dhe negative që u  
çekën ma lart, por randësia e tij gjuhësore asht e pamasë, pse në të  
mund të shifen ndërrimet që ka ba gjuha gjatë shekujsh. Po të studjo-  
het mirë, fjalori shtron përpara nesh një varg problemesh gjuhësore,  
prej kah mund të nxiren përfundime shumë të dobishme për historinë  
e gjuhës.

## R é s u m é

FRANG BARDHI ET SON «*DICTIONARIUM LATINO-EPIROTICUM*»  
de 1635

L'auteur, après avoir passé brièvement en revue les différents avis exprimés sur le *Dictionarium* de Frang Bardhi (Franciscus Blanchus), traite deux aspects principaux de ce dictionnaire: Où s'est basé Bardhi dans le glane du glossaire de son dictionnaire, et jusqu'à quel point correspondent les équivalents albanais aux lemmes latins, cela naturellement plusieurs exemples du dictionnaire à l'appui:

Ensuite l'auteur traite des adjectifs sans article, qui ont actuellement, dans la plupart des cas, leur article antérieur, et tire de là la conclusion, que plusieurs adjectifs, qui ont à l'heure actuelle l'article antérieur, en étaient dépourvus autrefois.

L'auteur traite aussi des adjectifs prépositifs et postpositifs de l'ancienne langue albanaise, toujours en se basant sur Bardhi.

Un dernier aspect, sur lequel s'arrête l'auteur, est celui des mots du dictionnaire de Bardhi, qui trouvent leur utilisation comme néologismes dans l'albanais d'aujourd'hui.

L'auteur est de l'avis que le dictionnaire a été élaboré sur la base d'une cartothèque éditée sur la lecture des livres confessionnels et non point d'un dictionnaire bilingue quelconque de cette époque. Plusieurs erreurs grossières qu'on constate en certains cas dans la traduction des mots et des expressions ne peuvent être rattachées qu'aux erreurs d'imprimerie. Cela est confirmé par plusieurs lemmes et locutions latines, traduits assez bien en albanais. Mais la littérature passée en revue n'a pas été suffisante, et d'autant plus le glane des textes n'a pas été réalisé dûment: il lui manquent plusieurs mots d'usage courant et y figurent des mots très rares, c'est pourquoi le *Dictionarium* est très pauvre. L'ouvrage de Bardhi laisse entrevoir que les deux dialectes principaux ont été plus proches qu'ils ne le sont actuellement, du fait qu'on y trouve plusieurs formes qui n'existent actuellement que dans le dialecte méridional de l'albanais.

Toutes ces affirmations de l'auteur sont illustrées d'exemples tirés du dictionnaire en question.